

ANALIZË SOCIOLOGJIKE E MENDËSIVE DHE PERCEPTIMEVE MË NDIKUESE NË MARRËDHËNIET SHOQËRORE, NDËR STUDENTËT E UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË

Doktorant Sherif Dervishi

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

sherif.dervishi@unitir.edu.al

Abstrakt

Ky studim paraqet një analizë sociologjike të mendësive dhe perceptimeve në marrëdhëniet ndërpersonale të studentëve të Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë. Duke u fokusuar te proceset e shoqërizimit, ndërveprimit gjinor dhe modelet e komunikimit ndërmjet studentëve, evidentohet mënyra se si vlerat tradicionale dhe ato moderne ndërthuren në formësimin e sjelljes shoqërore. Në këtë punim, ku janë anketuar 104 studentë, analizohen disa nga perceptimet e studentëve për bashkëstudentët e tjerë nëpërmjet disa pyetjeve kërkimore si: A konsiderojnë ndonjë bashkëstudent si shoqe/shok të ngushtë? Çfarë tipari çmojnë më shumë te shoqja/shoku më i afërt? Cili faktor ndikon më së shumti në krijimin e grupit të shoqeve/shokëve universitar më të afërt? Si ka ndikuar periudha e pandemisë Covid-19, në marrëdhëniet shoqërore me bashkëmoshatarët e tyre? A ndiejnë konkurrencë me studentët e tjerë të ciklit të njëjtë të studimeve, për arritjen e rezultateve të larta në studime? Si e vlerësojnë një student ose studente që nuk është i/e përfshirë në rrjetet sociale? Gjetjet zbulojnë se studentët e Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, kanë mendësi dhe perceptime, tradicionale për sa i përket marrëdhënieve me bazë gjinore dhe kozmopolite në raport me respektimin e tjetrit ndryshe.

Fjalët kyçe: *perceptime, vlerësime, mendësi, konkurrencë, shoqërizim, interesa*

SOCIOLOGICAL ANALYSIS OF THE MENTALITIES AND PERCEPTIONS INFLUENCING STUDENT RELATIONSHIPS AT “FAN S. NOLI” UNIVERSITY, KORÇA

Abstract

This study presents a sociological analysis of the mentalities and perceptions shaping the interpersonal relationships of students at “Fan S. Noli” University in Korça. Focusing on the processes of socialization, gender-based interaction, and communication patterns among students, it highlights the ways in which traditional and modern values intertwine in the formation of social behavior. In this study, which surveyed a total of 104

students, several perceptions regarding peers were analyzed through a series of research questions, such as: Do students consider any of their peers as close friends? Which personal quality do they value most in their closest friend? Which factor most influences the formation of close university friendship groups? How did the Covid-19 pandemic period affect their social relationships with peers? Do they feel a sense of competition with other students in the same study cycle to achieve high academic results? How do they perceive a student who is not involved in social media networks? The findings reveal that students at “Fan S. Noli” University in Korça display traditional mindsets and perceptions regarding gender-based relationships, while exhibiting cosmopolitan attitudes toward respecting others who are different.

Keywords: *perceptions, evaluations, mindsets, competition, socialization, interests*

1. Hyrje

Ndikimi social ndodh jo vetëm brenda dysheve të miqësisë, por edhe në grupe më të mëdha shoqërore. Përvojat e të rinjve në këto grupe janë thelbësore (Ueno, K., 2005:3). Universiteti është mjedisi intelektual ku shumë nga mendësitë dhe perceptimet e të rinjve modifikohen drejt modeleve më të mira sidomos nga ndërveprimi me të tjerë në nivel makro, duke lënë pas shkollën e mesme me kufizimet dhe paragjykimet moshore dhe krahinore. Mënyra se si individët e perceptojnë strukturën e rrjetit shoqëror përreth tyre ka qenë gjithmonë shqetësim i rëndësishëm në literaturën e rrjeteve akademike të shkencave humane (Brands, R. A., 2013:34).

Universitetet publike në Republikën e Shqipërisë tërheqin kryesisht studentë, të cilët banojnë në njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë ku ndodhet universiteti dhe njësitë administrative të bashkive të tjera përreth. Këtë profil ka edhe Univeristeti i Korçës “Fan S. Noli”, ku shumica e studentëve vijnë nga Qarku i Korçës.

Në një sfond të tillë nënkulturor, është me interes hulumtimi i perceptimeve që kanë studentët për shoqet dhe shokët e kursit ku vijnë studimet, çfarë mendojnë për njëri-tjetrin dhe në çfarë gjendjeje psiko-emocionale zhvillohen marrëdhëniet shoqërore të përditshme. Vlerësimet dhe perceptimet që studentët kanë për njëri-tjetrin shihen si tregues të mjedisit universitar me qasje pozitive ose konfliktuale.

Mjedisi universitar miqësor është i rëndësishëm për lidhjet emocionale pozitive të studentëve me institucionin, për të përparuar maksimalisht në studime. Mjedise të tilla miqësore të krijuara nga pedagogët me përvojë, janë të sfiduara të zhvillohen me kahje pozitive ose jo, nga studentët në ndërveprim të përditshëm me njëri-tjetrin.

Sfondi i mendësive dhe nënkulturave që studentët e zonave të ndryshme mbartin, divulgojnë duke u fërkuar ose përshtatur me njëri-tjetrin në procesin e shoqërizimit të përditshëm.

Perceptimet e studentëve për njëri-tjetrin janë të vlefshme për të bërë përgjithësime dhe mbi perceptimet e të rinjve shqiptar, të këtij çerek shekulli të parë të shekullit XXI, të cilët në një kohë të afërt do të dalin në tregun e punës si profesionistë në fusha të ndryshme.

Në vijim gjenden disa tregues demografikë për 104 studentët e anketuar në Universitetin e Korçës:

Tabela 1 (të dhënat në përqindje)

	Sipas përkatësisë gjinore		Sipas vendbanimit		Sipas statusit të punësimit	
	Vajza	Djem	Në qytet	Në fshat	Të punësuar	Të papunësuar
Bachelor	86	14	52	48	35	65
Master	80	20	58	42	79	21

Mbështetur në faktin që studentët e anketuar janë të degës infermieri, gjuhë të huaja dhe sociologji-filozofi, mund të themi që shpërndarja gjinore në Universitetin e Korçës, është e ngjashme me universitetet e tjera publike në vend.

Kështu sipas INSTAT-it, nga **28,193 studentë** që përfunduan arsimin e lartë në vitin 2024, rreth **65.8 %** ishin vajza dhe rreth **34.2 %** djem. Fushat më të parapëlqyera nga vajzat ishin: *Shkencat Shoqërore, Gazetari e Informacion* rreth 83.0 %, *Shkencat e Edukimit* rreth 81.7 %, dhe *Shëndeti dhe Mirëqenia* rreth 78.9 % (2024). Mbi këto tregues, studentet vajza të Universitetit “Fan S. Noli”, janë rreth 3 % më shumë se mesatarja e vajzave në universitetet e tjera publike që kanë zgjedhur këto fusha të preferuara. Ndërkohë numri i djemve që nuk vijnë në arsimin e lartë mbetet shqetësues edhe në Prefekturën e Korçës.

Sipas theglobaleconomy.com, indeksi (raporti femra: meshkuj) i studentëve të regjistruar në universitetet publike të Republikës së Shqipërisë ishte rreth **1.32**, që do të thotë rreth 32% më shumë femra se meshkuj në arsimin terciar. Mesatarja botërore është rreth **1.16** (2023).

Dihet se një numër i konsiderueshëm i djemve nuk e vijojnë arsimin e lartë, kjo bën të thellohet ndjeshëm shpërpjesëtimi ndërmjet djemve dhe vajzave që diplomohen.

Ky studim ka një rëndësi të veçantë në kuadër të kërkimeve sociologjike bashkëkohore, pasi kontribuon në kuptimin më të thellë të mënyrës se si proceset e shoqërizimit, komunikimit dhe perceptimit gjinor formësojnë marrëdhëniet ndërmjet të rinjve në mjedisin universitar.

2. Metodologjia

Metoda kryesore e përdorur për grumbullimin e të dhënave të këtij studimi është anketimi, përgatitur mbi bazën e shfletimit paraprak të një informacioni mbi teoritë e komunikimit, sjelljeve dhe konflikteve tek të rinjtë.

U përcaktuan pyetjet kryesore që do t'u drejtoheshin studentëve që do të pranonin të anketoheshin. Pyetësi përmbante 89 pyetje të strukturuar që ofronin 343 alternativa përgjigjesh dhe shtatë pyetje të hapura. Përpunimi i të dhënave, është realizuar me anë të programit SPSS. Gjithsej janë realizuar 104 anketa të vetadministrueshme, 84 në nivelin bachelor dhe 20 në nivelin master.

Analiza e bisedave shpesh mbulon ato që mund të dukeshin thjesht aspekte të parëndësishme të jetës së përditshme, por që kanë një rëndësi të madhe në sociologji. Në fund të fundit bisedat janë tipare universale të veprimtarisë shoqërore” (Giddens; A., 2006: 225). Studimi i çdo dukurie shoqërore mund të kryhet nga këndvështrime të ndryshme dhe, për të krijuar një tablo më gjithëpërfshirëse të asaj që ndodh, mund të përdoren metoda të ndryshme për të mbledhur lloje të ndryshme të dhënash (Matthews, B; Ross, L., 2010:144).

Janë anketuar 74 studentë nga dega Infermieri dhe 10 studentë nga dega Gjuhë Angleze e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në nivelin bachelor dhe 20 studentë të nivelit master të Fakultetit të Shkencave Humane. Studentët e anketuar ndjekin kurse të ndryshme të studimeve.

Pyetësorët u përgatitën duke u përpjekur të përdorej një gjuhë sa më e qartë dhe e kuptueshme për studentët, të cilët do të plotësonin pyetësin. Plotësimi i pyetësorëve të përgatitur u realizua në auditoret e fakulteteve përkatëse të secilit grup studentësh gjatë pushimit mes orëve të lira dhe seminareve.

Për ngritjen e pyetjeve kërkimore janë shqyrtuar burime literature profesionale, monografi dhe vepra të rëndësishme të fushës së sociologjisë së komunikimit. Analiza e të dhënave dytësore është e rëndësishme sepse, së pari e ndihmon hulumtuesin të kursejë kohë e para për mbledhjen e të dhënave, të cilat janë mbledhur nga profesionistë të tjerë më parë dhe së dyti, të dhënat e marra nga burime zyrtare garantojnë nivel të lartë besueshmërie dhe vlefshmërie (Bouslaugh; S., 2007: 125).

Pyetësori është përgatitur në formatin “hard copy”, dhe përmban 7 faqe formati A4. Nuk u përdorën metoda bashkëkohore për mbledhjen e të dhënave empirike me formatin “Google form” pasi pyetësori ishte i gjatë. Ky pyetësor u testua paraprakisht me studentët e Universitetit të Tiranës, të cilët ndiheshin të lodhur nga plotësimi i pyetësorit përmes ekranit të vogël të telefonit celular. Plotësimi i këtij pyetësori me shkallë të lartë përgjegjësie, zgjaste mesatarisht 22-25 minuta. Gjithashtu për çështje sigurie të mbledhjes së të dhënave drejtëpërdrejtë, kam qenë vetë i pranishëm në çdo auditor ku janë plotësuar pyetësorët. Para plotësimit të pyetësorit, u kam paraqitur studentëve pyetësin dhe kam shpjeguar rëndësinë e tij.

Kësisoj besueshmëria e studimit nëpërmjet këtij filtri konsiderohet të jetë më e lartë.


Kufizimi i këtij studimi konsiston në numrin jo shumë të lartë të studentëve të anketuar. Gjithashtu në mungesën e zhvillimit të anketimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Fakultetin e Ekonomisë. Kufizimet e përmenduara lidhen me faktin që ky artikull është pjesë e një studimi të gjërë për veçoritë e komunikimit konfliktual ndër studentët e 12 universiteteve publike të Republikës së Shqipërisë, ku janë anketuar 1144 studentë (843 në programin bachelor dhe 301 në programin master,) gjatë muajit maj 2025.

3. Densitet i lartë shoqërizimi, edhe pas Pandemisë Covid-19

Pas viteve të pandemisë Covid-19 modelet e sjelljeve, të marrëdhënieve shoqërore u modifikuan ndjeshëm nga përpjekjet për t'i mbijetuar sëmundjes që kërcënonte njerëzimin në shkallë botërore. Sipas *Eurofound* (2022) **20% e të rinjve** të BE-së (nën 35 vjeç) deklaruan në vitin 2022 se ndiheshin të vetmuar “gjithmonë ose shumicën e kohës” – një nivel që nuk u ul menjëherë pas pandemisë. I lartë paraqitet dhe te studentët e Universitetit të Korçës ndikimi i pandemisë Covid-19, ku në total rreth 39% prej tyre pohojnë se pandemia ka ndikuar në zbehjen e marrëdhënieve shoqërore me bashkëmoshatarët e tyre. Të tjerët janë shprehur se *i ka përforcuar* rreth 9% dhe se *nuk i ka ndikuar fare* rreth 52%.

Pyetjes: “A keni ndonjë studente vajzë të të njëjtit cikël studimi të cilën e konsideroni shoqe”, studentët e nivelit bachelor dhe master janë përgjigjur si më poshtë:

Grafiku 1 (Të dhënat për studentët e nivelit Bachelor, shprehur në %)



Grafiku 2 (Të dhënat për studentët e nivelit Master, shprehur në %)




Rreth 84% e studentëve të nivelit bachelor, kanë të paktën një studente që e konsiderojnë shoqe. Ky tregues konsiderohet i lartë dhe pozitiv, sidomos në klimën e marrëdhënieve njerëzore përgjithësisht disi të zbehta, pas periudhës së pandemisë Covid-19. Ndërkohë rreth 90% e studentëve djem në nivelin bachelor kanë pohuar se nuk konsiderojnë ndonjë studente vajzë si *shoqe*. Përgjithësisht djemtë kanë më pak shoqëri me vajzat. Ata kryesisht mbajnë shoqëri të afërt me djemtë. Kjo dukuri theksohet nga të dhënat e grafikëve të mësipërm, konkretisht te treguesit e studentëve djem, krahasuar me studentet vajza të nivelit bachelor dhe master që janë më të gjera në marrëdhëniet shoqërore me gjininë tjetër. Të dhënat e mësipërme përforcojnë argumentimet e studiuesve të ndryshëm bashkëkohorë se marrëdhëniet shoqërore në përgjithësi janë ndikuar në masë të konsiderueshme nga Pandemia Covid-19.

Sociologu Zyhdi Dervishi në lidhje me këtë ka shkruar: “Tejkalimi i rrjedhøjave të kësaj pandemie, sidomos në rrafshin psikokulturor dhe në marrëdhëniet ndërpersonale do të jetë një proces shumë i vështirë, i ndërlikuar dhe afatgjatë, që bazohet me përparësi në davartjen e “mjegullës” së dyshimeve të ndërsjella ndërmjet njerëzve, të përforcuara nga kriza e besimit e shkaktuar prej pandemisë Covid-19” (2023:60).


Lipset analizuar çëshjta nëse pasja e një shoqeje ose shoku të afërm fakulteti lidhet me empatinë apo interesa të momentit. Çështjet që do të ngremë gjatë këtij artikulli, do të na ndihmojnë të kuptojmë më shumë rreth tipologjisë së shoqërizimit në këto nivele të larta.

Në vijim të njihemi me përgjigjet e djemve të programit bachelor, për pyetjen: “A keni ndonjë student djalë të të njëjtit cikël studimi të cilin e konsideroni shok”:

Grafiku 3 (Treguesit për studentët e nivelit Bachelor, shprehur në %)



Grafiku 4 (Treguesit për studentët e nivelit Master, shprehur në %)



Vajzat përgjithësisht janë më të shoqërueshme, dhe ato ndikojnë më shumë për ruajtjen e marrëdhënieve shoqërore me djemtë. Pak më shumë se gjysma e vajzave të ciklit bachelor pohojnë se kanë një bashkëstudent djalë që e konsiderojnë shok. Nga ana tjetër, rreth 72% e djemve të ciklit bachelor, pohojnë se kanë një bashkëstudent djalë që e konsiderojnë shok. Këto tregues përforcojnë mendësitë stereotipizuese, që vajzat janë më të shoqërueshme me të dyja gjinitë, se djemtë janë më të shoqërueshëm me djemtë dhe burrat në përgjithësi.

Në nivelin master, përgjigjet e djemve janë me ngjyime të skajshme, ku të gjithë djemtë e anketuar pohojnë se kanë të paktën një djalë bashkëstudent që e konsiderojnë shok.

Studentët master, janë më të mëdhenj në moshë madje, shpesh herë, edhe të moshave të ndryshme, me diferenca moshore mes bashkëstudentëve. Për këtë arsye, konsiderohen më të pjekur emocionalisht dhe më objektiv në dhënien e përgjigjeve, se sa

studentët e nivelit bachelor, ku me përjashtim të rasteve të ralla shumica janë bashkëmoshatarë.

Vajzat e nivelit master, shoqërizohen me studentë djem të të njëjtit cikël studimi me rreth 9% më shumë se vajzat e nivelit bachelor. Në vitet e para të studimeve të nivelit bachelor, një pjesë e marrëdhënieve shoqërore e vajzave me studentët djem, bashkëshoqërohen me mungesë besimi, paragjykime dhe konflikte për keqkuptime të rastit. Në nivelin master, dendësia e konflikteve përgjithësisht zvogëlohet dhe shoqërizimi është me nota më serioze, duke ndërvepruar me njëritjetrin me më shumë përgjegjësi dhe respekt të ndërsjellë.

4. Mendësi e përgjithshme: Shoqërim i lidhur me interesa

Nëse shumica e studentëve vlerësonin *singeritetin* (mbi 45%) si tipar dallues të shoku ose shoqja më e afërt, ndryshe shfaqet perceptimi i përgjithshëm i tyre kur pyeten në përgjithësi për mendimin e tyre rreth faktorit kryesor që ndikon më së shumti në formimin e shoqërive më të afërta në universitet.

Kështu pyetjes: “Sipas mendimit tuaj, cili faktor ndikon më shumë në krijimin e grupit të shokëve dhe shoqeve më të afërta në fakultet”, studentët e nivelit bachelor dhe master janë përgjigjur me rreth 59% se faktor kryesor në krijimin e shoqërive në universitet janë *interesat e përbashkëta*, duke e rritur me rreth 14% peshën specifike të studentëve që mendojnë se ngjashmëria në interesa ndikon në krijimin e grupeve shoqërore, duke zbehur *singeritetin* si tipar vlerësues.

Grafiku 5 (Treguesit për studentët e nivelit Bachelor, shprehur në %)



Sipas grafikut të mësipërm rreth 55% e studenteve vajza me dhe rreth 62% e studentëve djem që studiojnë në nivelin bachelor, janë shprehur se ngjashmëria në interesa është faktor që ndikon më shumë

në krijimin dhe mbarëvajtjen e shoqërive në universitet. *Të qenit banor nga i njëjti vend* ose me nënkulturë të njëjtë është më e rendësishme për vajzat, rreth 27%, se sa për djemtë rreth 8%. Djemtë janë më të prirur të kenë shoqëri jashtë rrethit nënkulturore, duke vlerësuar më shumë *mendësitë e përafërta* me rreth 20% se sa vajzat me rreth 13%. Vajzat e lidhin mendësinë e përafërt me shokët dhe shoqet e universitetit, më së shumti me gjeografinë e vendit nga ku ato vijnë. Si peshë specifike në tërësi, vajzat e nivelit bachelor mendojnë se faktor kryesor në krijimin e grupeve shoqërore më të afërta janë *afërsia gjeografike* dhe *mendësitë e përafërta* me bashkëstudentët, në masën rreth 39%, e renditur si tregues i dytë pas *ngjashmërive në interesa*, rreth 55%.

Paraqitet e ndryshme tabloja për studentët e nivelit master, të cilët në masë dërrmuese, vajzat rreth 88% dhe djemtë rreth 91%, pohojnë se ngjashmëria në interesa është faktori kryesor që ndikon më së shumti në krijimin e grupeve shoqërore universitare më të afërta. Këto shifra vijnë me të njëjtën logjikë të analizuar dhe nga treguesit e mësipërm ku studentët e nivelit master ishin më të qartë dhe të unifikuar në përgjigjet e dhëna me kahje interesash objektive dhe pikëpamje pragmatike krahasuar me studentët e nivelit bachelor, të cilët janë më të shpërndarë në zgjedhjet e alternativave të ndryshme.

Grafiku 6 (Treguesit për studentët e nivelit Master, shprehur në %)



Disa nga treguesit e tjerë nuk kanë marrë asnjë peshë përfaqësuese ose e kanë humbur atë peshë në njërin nga gjinitë. Ndër studentet vajza të nivelit master ka humbje me rreth 15% të peshës specifike të ndikimit që ka faktori i *të qenit banor nga i njëjti vend* për krijimin e grupeve shoqërore më të afërta. Gjithashtu edhe te djemtë e nivelit

master bie me rreth 11% pesha specifike e atyre që mendojnë se *mendësitë e përbashkëta janë* faktor ndikues në krijimin e grupeve shoqërore. Ndërkohë theksohet dukshëm bindja kolektive e studentëve të nivelit master me rreth 89.5% se faktori që ndikon më shumë në krijimin e grupit të shoqeve dhe shokëve më të afërta është *ngjashmëria në interesa*.

5. Konkurrencë anemike, shprehje e pasigurisë për të ardhmen

Dobësimi i ndikimit të institucioneve të arsimit të lartë kudo në botë, si dalje në plan të dytë nga zhvillimet e vrullshme teknologjike, ekonomike-sociale etj, ka shkaktuar një huti dhe mosvlerësim të shumë profesioneve të nderuara, të cilat shihen me skepticizëm për të ardhmen e tyre në një botë digjitale. Në një botë ku realiteti virtual po përparon gati në progresion gjeometrik, miliona e miliarda fitime financiare nga pëmbajtje në rrjetet sociale me foto dhe video ku shumica hidhen për arsye argëtimi, të rinjtë e sotëm ndihen të plogësht nga ideja se një punë e zakonshme pas studimeve universitare nuk është mjaftueshëm shpërblyese për të përballuar jetën me kostot financiare të larta, gjithnjë e më të papërballueshme. Kjo mendësi është e reflektuar dhe në vendin tonë.

Mjaft prej studentëve me të cilët kam patur mundësi të flas si pedagog i ri, rreth punësimit dhe rrjeteve sociale, janë shprehur se shkollën duan ta mbarojnë sa për ta pasur në CV. Përpyekjet për të mbaruar shkollën duan që t'i kenë minimale, pasi shumica e tyre mendojnë se nuk do të punojnë në fushën ku janë arsimuar, por diku tjetër.


Pasiguria e së ardhmes ndër të rinjtë dhe emigrimi janë dy elemente të lidhura ngushtë që reflektojnë sfidat dhe gjendjen psikosociale të paqendrueshme të shoqërisë shqiptare.

A.I student në vitin e tretë, Bachelor për informatikë, në universitetin e Tiranës, shprehet:

“Mendoj se qëllimi për të emigruar nuk do të thotë në të vërtetë se një person do të emigrojë për një të ardhme të afërt. Por emigron sepse të ardhmen e largët nuk e sheh në Shqipëri” (Kërçuku, B., 2023:122).

Kësisoj konkurrenca për rezultate të larta në studime bie në mënyrë drastike. Pyetjes: “A ndjeni konkurrencë me studentët e tjerë të ciklit të njëjtë të studimeve për arritjen e rezultateve të larta në studime”. Studentët i janë përgjigjur sipas grafikëve të mëposhtëm:

Grafiku 7 (Treguesit për studentët e nivelit Bachelor, shprehur në %)




Siç mund të lexohet nga të dhënat e grafikut, pesha specifike e studentëve të nivelit bachelor që shprehen se ndiejnë konkurrencë me studentët e tjerë është gjithsej 25.5%, vajzat rreth 38% dhe djemtë rreth 13%. Dukshëm vajzat janë më konkurrenciale se sa djemtë. Marion Porath, shprehet që vajzat kanë më shumë kapacitet arsyetimi në situata ndërpersonale dhe, për këtë arsye, raportojnë më saktë rrjetin sesa djemtë (2001:115).

Mjaft fakte të qëmtuara në jetën e përditshme provojnë se në mjediset urbane vajzat dhe gratë nxisin njëra-tjetrën të përparojnë jo vetëm në karrierë profesionale, por edhe në karrierën shoqërore e politike. Këtë prirje e përforcon rritja e përshkallëzuar e numrit dhe e peshës specifike të vajzave e grave me arsimim më solid, që përfundojnë studimet universitare dhe mbiuniversitare me rezultate më të mira se ato të djemve dhe burrave (Dervishi, Z., 2011:250).

Duhet theksuar fakti se shumica e studentëve të anketuar janë nga dega e Infermierisë. Përgjithësisht studentët e fushave mjekësore kanë qenë dhe mbeten më konkurrencial në studime edhe për arsye të seriozitetit të profesionit ku kanë të bëjnë drejtëpërdrejtë me përgjegjësi që lidhen me jetën e njeriut. Kësisoj pesha specifike totale e studentëve që përjetojnë konkurrencë rritet ndjeshëm nga studentët e infermierisë.

Ndryshe paraqitet tabloja me studentët e nivelit master, të cilët janë nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Pesha specifike e studentëve master në total që *nuk ndiejnë konkurrencë ose nuk u intereson konkurrenca për studime* është mjaft e lartë, vajzat rreth 77% dhe djemtë të gjithë ose 100% e tyre.

Grafiku 8 (Treguesit për studentët e nivelit Master, shprehur në %)



Pesha e lartë specifike e studentëve të nivelit bachelor rreth 48% dhe e studentëve të nivelit master rreth 78% që janë shprehur “*nuk më intereson konkurrenca për studime*” shpreh niveleve të larta të krizës arsimore dhe shpirtërore me perceptim kolektiv për një të ardhme të pasigurt. Në një nga pyetjet e hapura të anketës, rreth sfidave që ndjejnë studentët në universitet, 3 studentë të Universitetit të Korçës janë shprehur me tone pesimiste, duke vënë theksin se nuk kanë motiv të mjaftueshëm për të vijuar studimet, pra vijnë në universitet pa dëshirë. Shoqëria pasmoderne karakterizohet nga pasiguria dhe sikurse thekson Bauman, në modernitetin likuid asgjë nuk është e garantuar (2008: 94).

Në një intervistë, sociologu Zyhdi Dervishi është shprehur: “*Shoqëria shqiptare sot, përjeton strese shumë të rënda nga sistemi ynë i drejtësisë. Tani është krijuar bindja se në drejtësinë shqiptare nuk mund të gjeshe drejtësi, se sot drejtësia mund të blihet me para. Shqiptarët janë viktimë të papunësisë, të padrejtësive, dhe kanë humbur shpresat për të ardhmen. Mosfunksionimi i drejtësisë në mënyrë reale sjell si pasojë një kosto shumë të rëndë për shoqërinë shqiptare*” (Telegraf: 2014).


6. Respekt dinjitoz për të tjerët ndryshe

Në epokën digjitale ekzistojnë me dhjetra e qindra mundësi argëtimi dhe punësimi, të cilat mundësohen posaçërisht edhe nga përdorimi masiv i rrjeteve *online* në platforma të ndryshme. Mospasja e një profili aktiv në botën virtuale, natyrshëm hedh dyshime mbi mendësitë e dikujt që nuk është i përfshirë në to. Ato që qëndrojnë jashtë botës virtuale janë persona në moshë të shtyrë ose persona

ultrafetarë. As fëmijët e vegjël nuk janë më plotësisht të përjashtuar nga përdorimi i rrjeteve sociale. Gjithashtu dhe në vendet e botës së tretë e të përfshira nga lufta, njerëzit kanë akses në internet dhe përdorin masivisht profile aktive në rrjetet sociale. Kësisoj në këtë panoramë globale, një i ri që nuk ka rrjete sociale, i ka mbyllur apo nuk i përdor, shikohet me sy tjetër nga shoqëria masive. Kjo është një nga karakteristikat dhe pasojat e globalizmit. Sipas Gidens, globalizimi është “intensifikimi i marrëdhënieve shoqërore mbarëbotërore që lidhin hapësira të largëta lokale në një mënyrë të tillë që ngjarjet lokale formësohen nga ato që ndodhin shumë larg dhe anasjelltas”, duke ndryshuar kështu të gjitha aspektet e jetës sonë të përditshme (1990: 64).

Për të kuptuar se ç’perceptim dhe vlerësim kanë studentët e Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, për bashkëstudentët që nuk janë të përfshirë në rrjetet sociale, ju drejtua pyetja: “Si e vlerësoni një student/studente që nuk është i/e përfshirë në rrjetet sociale”:


Grafiku 9 (Treguesit për studentët e nivelit Bachelor, shprehur në %)



Është tregues pozitiv fakti që shumica e vajzave rreth 56%, dhe djemve rreth 80%, të programit bachelor shprehën se respektojnë zgjedhjen e tjetrit për të mos qenë i përfshirë në rrjetet sociale. Megjithatë një numër i konsiderueshëm i vajzave, rreth 37% mendojnë se të rinjtë që nuk përdorin rrjete sociale janë *jashtë kohës*,

madje rreth 7% e tyre, i etiketojnë edhe si të çuditshëm. Këta paragjykojnë më shumë nga vajzat (rreth 10%) se sa nga djemtë. Gjithsesi niveli i mirëkuptimit dhe tolerancës për studentët që nuk janë të përfshirë në rrjetet sociale është në nivele të larta.

Grafiku 10 (Treguesit për studentët e nivelit Master, shprehur në %)



Te studentët e programit master ka unanimitet të plotë të zgjedhjes së përgjigjes *respektoj zgjedhjen e personit* në masën 100%. Studentët e nivelit master nuk paragjykojnë askënd për mospërfshirje aktive në rrjetet sociale. Ky qëndrim i studentëve të masterit është në vijim të gjithë qëndrimeve të mëparshme të shprehura në grafikët e mësipërm, si tregues i drejtpeshimit të situatave me maturi dhe përvojë. Kjo është shprehje e qytetarisë së studentëve të rrethit dhe qytetit të Korçës. Korçarët përgjithësisht njihen për tolerancë, qytetari dhe arsimdashje. Hapja e Liceut francez të Korçës në gjuhët frëngjisht dhe shqip në 25 tetor 1917 ishte një arritje e madhe për popullsinë vendase. Ky do të ishte një moment historik, jo vetëm për qytetin dhe rajonin por edhe për të gjithë vendin, pasi Liceu ishte shkolla e parë e mesme publike dhe laike, deri në fillim të viteve 1920’ kur hapet gjimnazi i shtetit në Shkodër (Salih, B., 2024:80).

Emigracioni i hershëm i qytetarëve korçarë kryesisht në Europën perëndimore dhe SHBA, ka patur ndikim të madh në zhvillimin e Korçës sipas modeleve perëndimore në art, kulturë, arkitekturë dhe në jetën socio-ekonomike. Një prej trashëgimtarëve shqiptaro-amerikanë, Gregori Stefoni, tregon se ishin 400 familje shqiptare nga Korça që u vendosën atje në vitin 1900 dhe filluan të organizohen gjatë vitit 1915.

Sot, komuniteti shqiptar i mirintegruar përbën pesë për qind të rreth 180 mijë banorëve të qytetit të Usterit në Masaçusets të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky komunitet, i cili jep kontribut në fusha të ndryshme për zhvillimin e qytetit, ka luajtur një rol me rëndësi në prezantimin e Shqipërisë përmes ruajtjes së kulturës dhe traditave në pesë breza me radhë. Rreth kësaj periudhe u themelua kisha ortodokse shqiptare, duke u shndërruar në një qendër me rëndësi për komunitetin (Albinfo.ch:2025).

Gjatë shekullit XX ka një radhë të gjatë mirëbërësish korçarë e shoqata mirëbërse në mërgim dhe në atdhe që kanë kontribuar sidomos për arsimin dhe shkollën shqipe. Një ndër figurat më të rëndësishme të mirëbërësisë korçare është Anastas Avramidh Lakçe (1821-1894). E para vepër mirëbërëse e tij në fushë të arsimit është ngritja e një shkolle fillore në Korçë në vitin 1867 (Tollkuçi, J., 2019:184).

Këto karakteristika të nënkulturës së zonës së Korçës ndikojnë në shoqërizimin e mirë të qytetarëve me njëri-tjetrin, duke zhvilluar ndjenjën e komunitetit dhe pronës publike dhe intelektuale të përbashkët. Kultura kineze thekson funksionin e socializimit të grupeve të bashkëmoshatarëve në ndihmë të të rinjve për të mësuar normat shoqërore dhe për të zhvilluar sjellje të përshtatshme (Chen et al., 2005). Një frymë të tillë bashkëpunimi lipset ta kemi plan kombëtar për shoqërizimin dhe njohjen e të rinjve me njëri-tjetrin, që t'u jepen hapësirat e duhura për të shpenzuar energjinë e tyre në zhvillimin e vendit sipas shembujve të patriotëve të shquar shqiptar në shekuj.

Përfundime

Komunikimi i studentëve pëson ndryshime të dukshme gjatë viteve të studimeve nga forma më formale dhe e rezervuar drejt ndërveprimit më bashkëpunues dhe emocionalisht më të pjekur.

Gjetjet tregojnë për një dualitet vlerash mes mendësive tradicionale dhe përparimit të vazhdueshëm me karakteristika globaliste, të bashkëveprimit në mjedisin universitar.

Faktorë si origjina, nënkultura, përkatësia urbane ose rurale, luajnë rol të rëndësishëm në formësimin e modeleve të sjelljes, mendësive dhe perceptimeve për njëri-tjetrin në jetën studentore.

Arsimi i lartë nuk është vetëm një hapësirë e të nxënit akademik, por edhe një arenë dinamike e transformimit shoqëror, ku mendësitë tradicionale bashkëjetojnë dhe gradualisht shkrihen me vlerat moderne e emancipuese të komunikimit, bashkëpunimit dhe barazisë gjinore.

Pavarësisht paragjyimeve të mbetura, vihet re prirja në rritje drejt barazisë gjinore dhe respektit reciprok. Studentët në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, shfaqin vetëdije të lartë për vlerat e diversitetit.

Bibliografia:

Bauman, Zigmund: *Paura Liquida*, Laterza, Roma-Bari 2008.

Boslaugh, Sarah: *Secondary data sources for public health: A practical guide*. Cambridge University Press. 2007

Brands, R.A., 2013. Cognitive social structures in social network research: a review. J. Organ. Behav. 34 (S1), S82eS103. <http://dx.doi.org/10.1002/job.1890>

Ueno, K., 2005. The effects of friendship networks on adolescent depressive symptoms. Soc. Sci. Res. 34 (3), 484e510. <http://dx.doi.org/10.1016/j.ssresearch.2004.03.002>

Porath, M., 2001. Young girls' social understanding: emergent interpersonal expertise. High. Abil. Stud. 12, 113e126. <http://dx.doi.org/10.1080/13598130120058716>.

Chen, X., Chang, L., He, Y., Liu, H., 2005. The peer group as a context: moderating effects on relations between maternal parenting and social and school adjustment in Chinese children. Child. Dev. 76 (2), <http://dx.doi.org/10.1111/j.1467-8624.2005.00854.x>

Dervishi, Zyhd. "Pandemia Covid-19: cunam dyshimesh që lëkundin edhe kolonat e altruizmit të shkencave mjekësore" *Lente sociologjike* 4, nr. 1, Tiranë 2023.

Dervishi, Zyhd. *Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*. “Emal”, Tiranë 2011.

Giddens, A. *Sociology* (5th ed.). Polity Press. 2006.

Giddens A., *The Consequences of Modernity*. Stanford University Press: Stanford, CT 1990.

Kërçuku, Blerina. “Emigrimi i studentëve dhe ndikimi i tij në kapitalin social” *Lente sociologjike* 4, nr. 1, Tiranë 2023.

Salih, B. *Aventura e Krahinës Autonome dhe Dinamikat e Administrimit të Rajonit të Korçës nën Protektoratin Francez (1916–1920)*, *Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe Zhvillimet Social-Ekonomike”*, Korçë 2023.

Matthews, B., & Ross, L. *Metodat e hulumtimit: Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*. CDE. 2010

Tollkuçi, Jorida. “Tradita mirëbërëse korçare dhe refleksione mbi vullnetarizmin në studimet e sociologut Zyhdi Dervishi “*Natyra dhe Kultura*”, nr. III, Korçë 2019.

<https://www.instat.gov.al/media/mxfl42go/statistikat-e-regjistrimeve-n%C3%AB-arsim-2024-2025.pdf>.

https://www.theglobaleconomy.com/albania/Female_to_male_ratio_students_tertiary_level_education/

<https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare/publikimet/2022/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare-2021/>

<https://www.instat.gov.al/media/14319/cens-2023-korca.pdf>

<https://www.eurofound.europa.eu/en/data-catalogue/living-working-and-covid-19-5th-round-may-2022>

<https://telegraf.al/dritarja-e-intelektualit/prof-zyhdi-dervishi-problemet-ne-arsim-jane-te-dyanshme-si-te-studenteve-dhe-te-pedagogeve/>

https://www.albinfo.ch/historia_e_400_familjeve_shqiptare_nga_korca_ne_nje_qytet_ne_shba/